



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Kavajë, më _____ .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ Datë ____ / ____ / 2025

“Për miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së me nr.3236 prot., datë 04.12.2024” të FSHF-së dhe nr.114/1 prot., datë 10.01.2025 të Bashkisë Kavajë”.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligji nr. 44 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 8750, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, VKB Nr. 68 datë 23.12.2024, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025”, VKB nr.49 datë 30.09.2024 “Per miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së”, Kryetari Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e radhës:

TË VENDOSË

1. Miratimin e aktmarrëveshjes ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe FSHF-së, me nr.3236 prot., datë 04.12.2024” të FSHF-së dhe nr.114/1 prot., datë 10.01.2025 të Bashkisë Kavajë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve dhe Drejtoria e Burimeve Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE

Adrian Malaj

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE

Andi Çurgu

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Deshira Qato

DREJTORIA E KULTURËS, TURIZMIT, TRASHËGIMISË DHE SPORTEVE

Gentian Jaupi

SEKRETARI KESHILLIT

Meri Biturku

KRYETARI
FISNIK QOSJA

